

Sa janë të kënaqur qytetarët e
zonave rurale të komunës së
Ferizajt me qeverisjen e tyre
lokale?

Ky hulumtim është përkrahur nga National Endowment for Democracy



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

Copyright © 2012, Iniciativa për Progres – INPO

INPO ka të gjitha të drejtat e rezervuara mbi këtë botim. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo shpërndahet në çfarëdo forme të mundshme pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

Qëndrimet e shprehura në këtë botim janë përgjegjësi vetëm e botuesit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen se përfaqësojnë qëndrimet e donatorëve që mbështesin INPO-në.

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
Trajtimi i problemit	4
Metodologjia dhe Mostra e hulumtimit	5
Paraqitja grafike e të dhënave kryesore	6
Përfundimet	10
Rekomandimet	11
Referencat	12
Për INPO	13

Hyrje

Ky hulumtim paraqet të dhënat e opinionit publik të katër fshatrave të komunës së Ferizajt për funksionimin e qeverisjes së tyre lokale dhe reflekton mendimet e qytetarëve të këtyre zonave për punën e komunës në përgjithësi dhe zyrtarëve komunal. Hulumtimi përfshinë popullatën e fshatrave: Greme, Nerodime, Pleshinë e epërme dhe Koshare, prej moshës 18 vjeqare dhe më tutje. Shtytja për hartimin e këtij hulumtimi rrjedh nga përpjekjet e INPO-s që t'i kontribuoj rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe iniciativës për komuna llogaridhënëse, që marrin parasysh mendimin e qytetarëve dhe zbatojnë modelin e politikës nga 'poshtë-lartë'.

Hulumtimi argumenton se kënaqshmëria e qytetarëve të këtyre zonave të Ferizajt me funksionimin e qeverisjes së tyre lokale është mjaft e ulët. Për më tepër rezultatet e hulumtimit flasin për një apati politike, ndryshe bojkot të publikut ndaj veprimtarisë së komunës. Më shumë se 50% e të anketuarve nuk informohen dhe nuk interesohen për veprimtarinë e komunës, kurse të dhënat kanë theksuar nivel të lartë pasiviteti përsa i përket angazhimit qytetar të të anketuarve, kur më tepër se 80% prej tyre nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në dëgjimet publike që i ka organizuar komuna e Ferizajt.

Hulumtimi gjithashtu konfirmon se qytetarët shfaqin plogështi për të komunikuar me institucionet komunale. Edhe pse INPO edhe në publikimet e më hershme ka tërhequr vërejtjen lidhur me mos-përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, si duket qeverisja lokale në Ferizaj nuk po e gjen dot zgjidhjen për tejkalimin e këtij problemi. Ky fakt paraqet një defekt serioz për një qeverisje që mbështetet në parimet e qeverisjes së mirë dhe që synon përmirësimin e objektivave siq janë rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Sipas të dhënave të mbledhura, pjesa më e madhe e të anketuarve janë treguar të kënaqur me shërbimet që i'u ofron administrata komunale, 62% e të anketuarve kanë qenë mesatarisht të kënaqur me shërbimet e administratës komunale. Shumica e të anketuarve kanë qenë të pa punë dhe si duket ky variabël ka pasur impakt të drejtëpërdrejt edhe tek perceptimi i qytetarëve për korrupsionin, ku 42% e të anketuarve mendojnë se zyrtarët komunal janë të korruptuar. Gjithashtu pjesa më e madhe e të anketuarve ka qenë me shkollim të mesëm dhe pas testimit të marrdhënieve (koeficienti Pearson) mes variablit të nivelit të shkollimit dhe pyetjes se a mund të ndikojnë qytetarët në agjendën politike të komunës, ne kemi arritur në përfundim se niveli i arsimimit ka ndikuar në përgjigjet e qytetarëve dhe rreth 55% e të anketuarve kanë shprehur bindjen se qytetarët nuk mund të ndikojnë në agjendën e komunës.

Në mënyrë që të ofrojmë një pasqyrë sa më reale të opinionit publik, kemi trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme problemin e hulumtimit, kemi bërë analizë objektive të të dhënave të mbledhura dhe kemi sugjeruar disa rekomandime për përmirësimin e gjendjes.

Hulumtimi si qëllime parësore ka rritjen e përfitimeve sociale dhe institucionale dhe minimizimin e zhvillimeve negative në procesin e vendimmarrjes.

Trajtimi i problemit

Sot, kur bëhet fjalë për vendet e BE-së dhe atyre që në të ardhmen aspirojnë të bëhen të tilla, si vendi ynë, është e pamundur të filtret për qeverisje demokratike në mungesë të participimit efektiv të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes për çështjet e nivelit lokal, që në mënyrë direkte kanë ndikim tek ata.¹ Pikënisje për hartimin e hulumtimit ka qenë reagimi i mëhershëm i INPO-s përmes komunikatës jo margjinalizim të fshatrave, por shërbime funksionale. Gjithashtu duke marr në konsiderat gjetjet nga raportet e monitorimit të komunës së Ferizajt, INPO ka vlerësuar si problem mjaftë shqetësues mospërfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, sidomos qytetarët e zonave rurale, që shpesh po ndihen të anashkaluar.

Deri tani mbajtja e takimeve publike dhe çështjeve tjera me interes publik nga komuna e Ferizajt nuk kanë rezultuar me sukses, madje ka pasur raste kur në dëgjimin publik ka ardhur vetëm një qytetarë.² Ky fakt duhet të merret më seriozisht dhe kurrësi nuk duhet të kuptohet si përmbushje e përgjegjësive nga komuna dhe se pjesëmarrja e qytetarëve është e drejtë civile dhe komuna nuk mund ta detyrojë askënd që të marr pjesë në aktivitetet e komunës. Komuna duhet domosdoshmërisht të ketë mënyra dhe mjete me të cilat e kupton mendimin e qytetarëve, me qëllim që t'i realizoj veprimet dhe aktivitetet e saj në përputhje me mendimin e qytetarëve, pasi që përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje është ndër parimet themelore të qeverisjes demokratike.

Që të mund të ndikojnë në vendimmarrje, qytetarët duhet të kenë mundësi ta shprehin mendimin e tyre, dëshirat që i kanë dhe prioritetet e tyre para organeve kompetente të vetëqeverisjes lokale. Pra është e kuptueshme se ekziston nevoja që komuna të krijojë mekanizma funksional për marrjen e informatave kthyesë nga qytetarët, me qëllim që qytetarët të kenë mundësi t'i shprehin nevojat e tyre, brengat dhe vërejtjet për mangësitë e shërbimeve komunale.

Kjo e drejtë e qytetarëve që të marrin pjesë në çështjet e qeverisjes lokale dhe të shprehin nevojat dhe prioritetet e tyre nuk i'u është dhënë atyre nga ndonjë autoritet qendror apo lokal. Në të vërtetë kjo e drejtë buron nga fakti se Kryetari i komunës dhe asambleja komunale zgjedhen drejtpërdrejtë nga vota e qytetarëve, për më tepër në mënyrë që qytetarët ta përmbushin rolin dhe përgjegjësinë e tyre si kontribues të financave komunale, komuna obligohet që t'iu mundësoj qytetarëve ta shprehin mendimin e tyre dhe t'i përshtat veprimet e saj me mendimin e qytetarëve.

Kështu duke njohur problemet e komunës për të komunikuar me qytetarë dhe rëndësinë e opinionit publik që është jetik për demokracinë, ne kemi vendosur që të hulumtojmë mendimin e qytetarëve të zonave rurale të Ferizajt, të kuptojmë sa janë të kënaqur me qeverisjen e tyre dhe

¹Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 3 thotë se: Sipas parimit të subsidiaritetit vendimet në qeverinë lokale duhet të merren në nivelin më të afërt të mundshëm me qytetarë.

² Për më tepër shih raportin e monitorimit "Komuna e Ferizajt- Janar-Qershor 2012", i disponueshëm në http://inpo-ks.org/sq/aktivitetet/post/raporti_i_monitorimit_komuna_e_ferizajt_janar_qershor_2012

pastaj të analizojmë se si ndikojnë faktorët e ndryshëm politik dhe social në nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve.

Metodologjia

Komuna e Ferizajt ka gjithsej 45 fshatra, në pamundësi për të hulumtuar opinionin e qytetarëve të të gjitha fshatrave, në këtë hulumtim parimisht kemi proceduar me dy mënyra të kampionimit (mostrës). Mënyra e parë, kampionimi rastësor i thjeshtë, ku çdo fshat ka pasur mundësi të barabartë që të përzgjedhet për t'i realizuar anketat. Konkretisht kemi shënuar në fletë të veqanta emrat e 45 fshatrave të Ferizajt që përbëjnë edhe objektin e studimit.³ Letrat me emrat e fshatrave janë hedhur në një kuti, janë përzier dhe janë përzgjedhur rastësisht 4 fshatra, Gremja, Neordimja, Pleshina dhe Kosharja.

Hulumtimi është realizuar duke përdorur metodën kuantitative ku mbledhja e të dhënave është bërë përmes pyetësorit që ka përmbajtur gjithsej 7 pyetje. Në mungesë të të dhënave të sakta të numrit të popullësisë, kemi shfrytëzuar rezultatet paraprake të regjistrimit të popullësisë (Qershor 2011), ku sipas këtyre të dhënave Ferizaj ka gjithësej 108,690 banorë.⁴ Bazuar në këto të dhëna mostra representative me një margjinë gabimi prej +/- 4% për komunën e Ferizajt (duke përfshirë Qytetin dhe të gjitha fshatrat) është që të anketohen rreth 400 qytetarë. Por pasi që ne kemi realizuar anketat vetëm në 4 fshatrat e Ferizajt gjithësej janë anketuar 52 respondentë. Respondentët kanë qenë qytetarë të moshës madhore dhe janë përzgjedhur sipas principit të rastësisë.

³ Sokoli, Lekë (2009): *Metodat e kërkimit në shkencat sociale*. Tiranë, Instituti i Sociologjis. Për më shumë rreth mënyrës së kampionimit shih kapitullin mbi Përfaqësueshmërinë dhe kodimin, fq.189


⁴ Rezultatet paraprake të regjistrimit të popullësisë 2011 në Kosovë, të disponueshme në http://esk.rks.gov.net/publikimet/cat_vieë/8-statistikat-e-popullësisë (Qasur në Shtator 2012)

Paraqitja grafike e të dhënave kryesore




Sa jeni të kënaqur me qeverisjen tuaj lokale?

■ Shume ■ Mesatarisht ■ Pak ■ Aspak




Sa ju ofron shërbime të mira publike administrata komunale?

■ Shumë ■ Mesatarisht ■ Pak ■ Aspak




A ju informon komuna për punët që i bënë?




Nëse po, në çfarë mënyre ?


■ Internet ■ Gazeta ■ Radio ■ Tv ■ Nuk informohem fare



A keni marrë pjesë në diskutimet publike të organizuara nga komuna e Ferizajt?



A mendoni se zyrtarët komunal janë të korruptuar?



Përfundimet

Bazuar në opinionin e të anketuarve, në përgjithësi qytetarët e zonave rurale janë të pakënaqur me qeverisjen e tyre lokale. Më shumë se 50% e qytetarëve janë të kënaqur me shërbimet që i'u ofron administrata komunale. Kategoria e të pa punësuarve ka treguar një pakënaqësi më të madhe me institucionet komunale, në përgjithësi kjo kategori nuk informohet për punët që i bënë komuna dhe nuk beson tek fuqia e publikut për të ndryshuar agjendën politike të komunës, që si duket po i kontribuon edhe më tepër pasivitetit të tyre.

Trendi i pakënaqshmërisë së qytetarëve me qeverisjen lokale është shoqëruar me perceptimin e tyre për korrupsionin. Nga përgjigjet e marra 41% e qytetarëve mendojnë se zyrtarët komunal janë të korruptuar, 40% e qytetarëve nuk e din nëse zyrtarët komunal janë të korruptuar kurse vetëm 17% e qytetarëve mendojnë se zyrtarët komunal nuk janë të korruptuar.

Sa i përket kategoris së të arsimuarve nuk është vërejtur ndonjë pakënaqësi e lartë, shumica e respondentëve kanë qenë me shkollim të mesëm dhe nuk mendojnë se mund të ndikojnë në agjendën politike të komunës. Kurse qytetarët me nivel të lartë të arsimimit janë përgjigjur se mund të ndikojnë në agjendën politike të komunës. Aspekti në të cilin qytetarët kanë qenë më të kënaqur ka qenë administrata komunale, ku 62% e qytetarëve në pyetjen se a ju ofron shërbime të mira publike administrata komunale janë përgjigjur mesatarisht.

Në përgjithësi qytetarët janë përgjigjur se komuna nuk i informon për punët që i bënë dhe se ata nuk informohen fare për punët e komunës. Kurse edhe ata pak qytetar që informohen, kishin televizionin si mjetin kryesor përmes të cilit informohen për aktivitetet e komunës. Shqetësimin më të madh e përbënë fakti se në pyetjen se a kanë marr pjesë ndonjëher në diskutimet publike që i ka organizuar komuna e Ferizajt, 83% e qytetarëve janë përgjigjur se nuk kanë marr pjesë asnjëher. Gjithashtu është për tu shqetësuar edhe bindja e qytetarëve se nuk e kanë fuqin e vendimmarrjes, kur pyetjes se a mund të ndikojnë qytetarët në agjendën politike të komunës 56% e qytetarëve i janë përgjigjur me jo ose nuk e di.

Të dhënat e mbledhura tregojn se qytetarët nuk informohen për punën e komunës dhe nuk marrin pjesë në bërjen e politikave, pra nuk po funksionon modeli i politikës nga *posht-lartë*. Të dhënat sugjerojnë se ka nevojë për ndryshim të qasjes dhe krijim të mekanizmave të përshtashëm për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje sepse vetëm kështu i kontribuohet forcimit të demokracisë në nivel lokal.

Rekomandimet

Nëse e shohim legjislacionin dhe rregulloret për qeverisjen lokale, krijojmë bindjen se komunat funksionojnë sipas standarteve të kërkuara për qeverisje të mirë dhe i përfshijnë qytetarët në bërjen e politikave. Por ky është vetëm modeli, ndërsa nëse e shohim praktikën ajo flet ndryshe. Fakti se qytetarët janë të pa interesuar për punët e komunës, hezitojnë t'i kërkojnë të drejtat e tyre, nuk besojnë se e kanë fuqinë e vendimmarrjes, kanë përceptim negativ për institucionet komunale dhe nuk marrin pjesë në diskutimet publike që i organizon komuna e Ferizajt, janë përfundimet që dalin nga ky hulumtim.

Në mënyrë që të tejkalohet kjo gjendje, INPO ka përmbledhur disa rekomandime:

- Në mënyrë që të rritet interesimi i qytetarëve për çështjet publike, politika më e mirë që komuna e Ferizajt mund ta ndjek është që të bëjë përpjekje që të zhvilloj mentalitetin tek qytetarët se funksioni i komunës është *që ti shërbej qytetarët*.
- Të inkurajohen qytetarët që t'i përdorin mekanizmat e kontrollit, në mënyrë që të besimi i tyre për punët e komunës dhe të minimizohet përceptimi për korrupsionin.
- Të krijohen mekanizma funksional për marrjen e informatave kthyesë nga qytetarët.
- Veprimtaria e komunës të jetë sa më transparente dhe e përgjegjshme. Këto dy parime janë themeli i ndërtimit të besimit në institucione. Konkretisht trajtimi me kohë dhe kualitativ i qytetarëve, bashkë me procedura jo të komplikuar, ka shumë ndikim tek përceptimi i qytetarëve për punën e institucioneve komunale.

Kufizimet e këtij hulumtimi janë: Mungesa e numrit të saktë të popullësisë që jeton nëpër fshatrat e komunës së Ferizajt, që ndikon drejtëpërdrejtë në mostrën e hulumtimit. Si dhe shtrirja e hulumtimit nëpër të gjitha fshatrat e komunës së Ferizajt. Në bazë të llogaritjeve të bëra në DSS Research, margjina e gabimit e kësaj mostre është +/- 4%.

Bibliografia

Matthews, Bob dhe Ross, Liz (2010): *Metodat e Hulumtimit*. Tiranë, Qendra për arsim demokratik.

Selimi, Ferid(2008): *Qeverisja vendore-Shqyrtime krahasimtare*. Vatra, Prishtinë.

Sokoli,Lekë (2009):*Metodat e kërkimit në shkencat sociale*. Tiranë, Instituti i Sociologjisë.

Burime të tjera:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Ligji për vetëqeverisjen lokale në Kosovë

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal(2009): *Transparenca lokale& pjesëmarrja publike*. Prishtinë

Statututi i komunës së Ferizajt

Sample size calculator : www.dssresearch.com

Raporti i monitorimit: Komuna e Ferizajt, Janar-Qershor 2012 http://inpo-ks.org/images/uploads/file/Raport_Fer_Jan_Qer_2012_final_.pdf

Për INPO

INPO është themeluar në vitin 2005 duke implementuar aktivitete që kanë ndihmuar integrimin e qytetarëve në proceset sociale dhe vendimmarrëse. Pas tri vite punë efektive, duke e parë të rëndësishme profilizimin e INPO-s, kemi përcaktuar fushën e politikave publike, si qëllimin bazë të punës së organizatës.

Edhe pse në INPO, në fillim të aktivitetit të saj, shumica e stafit kanë qenë pa përvojë të mjaftueshme në menaxhim dhe fushën e politikave publike, kemi arritur të dëshmojmë përkushtim dhe seriozitet në punën tonë. Në mbështetje të konsultimeve dhe disiplinës në punë; përmes performansave artistike protestuese, debatit, fushatave të avokimit, kemi arritur të ndryshojmë strategjitë dhe rregulloret jo-funksionale të institucioneve qeveritare lokale. Më tutje, ne kemi fituar respektin dhe besimin e qytetarëve duke ndërmjetësuar dhe lehtësuar në zgjidhjen e problemeve ose konflikteve administrative me qeverinë lokale.

Përgjatë shtatë viteve të punës intensive ne kemi ndërtuar raport të shkëlqyeshëm me mediat si dhe partneritet me organizata të ndryshme, duke qenë anëtar të disa rrjeteve të rëndësishme në Kosovë. Stafit i INPO-s është rritur, duke mundësuar kështu edhe rritjen e zonave të monitorimit, në më shumë komuna të Kosovës dhe duke zgjeruar programet e veprimtimit. Synimi që të jemi pjesë e rrjeteve rajonale është arritur dhe INPO do të vazhdojë të përmbush këtë qëllim, gjithmonë duke ruajtur raportet e mira me partnerët aktual.

Avokimi dhe fushatat sensibilizuese në fushën e politikave publike, përbëjnë aspektin më të suksesshëm të punës së organizatës gjatë këtyre shtatë viteve. Ne synojmë të jemi një partner konstruktiv në të gjitha proceset në kuadër të fushës sonë të veprimtarisë.

MBËSHKETUR NGA :



National Endowment *for* Democracy
Supporting freedom around the world

INICIATIVA PËR PROGRES - INPO

**RR: "AHMET KAÇIKU" 35/KATI 5 | FERIZAJ, 70000
KOSOVË**

TEL: +381 (0) 290 329 400 | +377 (0) 44 746 749

WWW.INPO-KS.ORG | E-MAIL: INFO@INPO-KS.ORG